



REPUBLIKA E KOSOVËS



KOMUNA E ISTOGUT

KONTRATË PËR PUNË

KOMUNA E ISTOGUT në vazhdim "Njësia e Prokurimit", të cilën e përfaqëson znj, Zizë Bujupaj, menaxhere e Prokurimit, Rruga "Fadil Ferati" Nr. 121 në njërën anë;

Dhe

Grupi I Operatoreve "ADEMAJ ARCH-ING" Shpk & "RAHOVICA-KOMERC Komuna e Prishtines, të cilën e përfaqëson z Valmir Ademaj, me Nr. Rexh. Biznesi, 71267903 "Kontraktuesi"), ne anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për punë e shënuara me poshtë:

TITULLI I KONTRATËS:

NDERTIMI I RRUGËVE NE GURRAKOC LOT 2

| | |
|-------------------------|---------------------------------------|
| <i>Nr. I prokurimit</i> | <i>633-19-4076-5-2-1/ C 244 LOT 2</i> |
| <i>Nr. I brendshëm</i> | <i>633 / 019 / 032 / 521 – LOT 2</i> |

Neni 1 Lënda:

1.1 Lënda e kontratës është ekzekutimi i furnizimeve dhe punëve në vijim nga ana e Kontraktuesit:

NDERTIMI I RRUGËVE NE GURRAKOC LOT 2

Neni 2 Çmimi

2.1 Çmimi total i punëve për aktivitetin e prokurimit NDERTIMI I RRUGËVE NE GURRAKOC LOT 2 – është: 53.565,20 €

dhe me fjalë: /Pesëdhjetë tremijë epesë çindegjashtë dhjetë pesë euro 20/100 €

2.2 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Kontraktuesit sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve përgjatë ekzekutimit të kontratës.

2.3 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

Marrëveshja e kontratës;

Kushtet e Veçanta të Kontratës;

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;

Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;

Oferta financiare (Paramasa dhe Paralogaria);

Plani për menaxhimin e kontratës

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 4 Komunikimet

4.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për Autoritetin Kontraktues mund të adresohen Autoritetit Kontraktues ose Menaxherit të Projektit i emëruar në Kushtet e Veçanta të Kontratës.

4.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për

pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

4.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

4.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin.

Për Autoritetin Kontraktues:
Komuna e Istogut

Për Kontraktuesin:
"Ademaj Arch- Ing" Shpk &
"Rahovica -Comerc"

| | | | |
|--------------------|---|--------------------|---|
| Emri: | Zizë Bujupaj | Emri: | Valmir Ademaj |
| Pozita: | Zyrtar Përgjrgjës i Prokurimit | Pozita: | Lider Grupit |
| Nënshkrimi: |  | Nënshkrimi: |  |
| Data: | 24.9.2019 | Data: | 24/09/2019 |
| Vu l a |  | V u l a |  |

PJESA III E KONTRATËS kushtet e veçanta

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

| Kushtet e Përgjithshme të Kontratës | | Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK |
|--|-----------|---|
| Përshkrimi i nenit | Neni. Nr. | |
| Ligji i zbatueshëm dhe gjuha | 2.1 | Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë. |
| | 2.2 | Gjuha e përdorur do të jetë GJUHA SHQIPE |
| Siguria e ekzekutimit | 10.1 | Shume e sigurisë së ekzekutimit është 10% e vlerës së përgjithshme të kontratës në afat prej 90 ditësh |
| Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit | 11.2 | Shuma minimale e sigurimit do të jetë: Sigurimi i vend punishtes do të jetë përgjegjësi e Operatorit Ekonomik dhe të gjitha dëmtimet e punëve, dëmtimet e pronës apo humbjet e materialeve dhe pajisjeve në vend punishte janë në përgjegjësi të Operatorit ekonomik deri në shumën e dëmtimeve apo humbjeve, sigurimi i vend punishtes do të jetë + 30 dite nga plani dinamik i ofruar pra nëse zgjasin punimet zgjatet edhe sigurimi i vend punishtes pra + 30 dite. |
| Fillimi i punëve | 17.1 | Data e fillimit do të caktohet në <i>planin e menaxhimit</i> |
| | 17.2 | Data e përfundimit e të gjitha Punëve do të jetë 60 ditë. |
| Dëmet e likuiduara | 19.1 | Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë 0.25% për ditë por jo më shumë se 10% e vlerës së kontratës. |
| Regjistri i punës | 20.1 | Ditari i Punës dhe Libri ndërtimor |
| Inspektimi dhe testimi | 22.1 | Menaxheri i Projektit është <i>i caktuar me vendim të ZKA</i> |
| Shkaqet kompensim për | 30.1 | Data e posedimit të vend punimit do të jetë 5 ditë pas nënshkrimit të kontratës. |
| Përgjegjësia mbi Defektet | 34.5 | Periudha garantuese e defekteve është 1 vite |
| Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve | 42.2 | Palët do të provojnë në mënyrë miqësore të zgjidhin marrëveshjet ku do të organizojnë së paku tre takime për zgjidhje miqësore e nëse këto takime nuk kanë efekt atëherë kompetente do të jetë gjykata. |
| Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore | 43.1 | Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet Gjykata Themelore në Prishtinë në pajtim me ligjin në Kosovë |